



RR E G U L L O R E
PËR
RRUGËT LOKALE DHE RRUGËT NË VENDBANIME

2014



Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 Neni 11, 12.2, 40, 17 shkronja (f), 40.2 , Ligji për Rrugët, nr. 2003/24, Ligji Nr/L-120 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Rrugët Nr.2003/11, Statutit të Komunës së Hanit të Elezit neni 6.2 shkronja (f), Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës neni 15 shkronja (a). Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 27.11.2014 miratoi:

**RR E G U L L O R E
PËR
RRUGËT LOKALE DHE RRUGËT NË VENDBANIME**

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet pozita juridike e rrugëve publike, ndërtimi, mirëmbajtja e rrugëve, masat mbrojtëse, qeverisja dhe mbikëqyrja e rrugëve lokale dhe atyre në vendbanime, në territorin e Komunës së Hanit të Elezit.

Neni 2

Rruga lokale është në përdorim të përgjithshëm dhe me interes për Komunën. Komuna është autoritet për rrugë publike, lokale dhe ato në vendbanime.

II. MENAXHIMI DHE FINANCIMI I RRUGËVE LOKALE

Neni 3

3.1. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë është kompetente për rrugët lokale, në territorin e komunës së Hanit të Elezit.

3.2. Drejtoria është e obliguar të informojë Kuvendin e Komunës së Hanit të Elezit për kryerjen e kategorizimit të rrugëve.

Neni 4

4.1. Drejtoria për Shërbime Publike është kompetente:

a/ të caktojë rrugë të veçanta për qëllime të veçanta, në rrugët lokale , urbane

b/ të ndajë një klasë të veçantë të rrugëve në nënklasë, në rrugët lokale , urbane

4.2. Sipas destinimit të tyre, rrugët lokale mund të dedikohen për pjesëmarrës në komunikacion rrugor (për automjete motorike, biçikleta, këmbësorë dhe shfrytëzues të tjerë), ose vetëm për automjete motorike.

4.3. Drejtoria mund të kategorizojë ndonjë rrugë ekzistuese të pa kategorizuar si rrugë lokale.

4.4. Drejtoria do të bëjë kategorizimin e rrugëve në përputhje me aktin e veçantë të Ministrisë së Infrastrukturës për kategorizimin e rrugëve.

Neni 5

5.1. Drejtoria është përgjegjës për menaxhimin, mirëmbajtjen dhe ndërtimin e rrugëve lokale dhe ato të vendbanimeve

5.2. Për menaxhimin, mirëmbajtjen dhe ndërtimin e rrugëve lokale Drejtoria kërkon këshilla nga Ministria.

Neni 6

6.1. Organi Shpronësues i Komunës është kryetari i Komunës, përveç nëse kuvendi komunal i komunës përkatëse, përmes një akti të miratuar në përputhje me nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, cakton një Autoritet tjetër Publik Komunal për të vepruar në cilësinë e Organit Shpronësues të Komunës. Ky organ bën shpronësimin e çfarëdo pjese të tokës, përrojeve, ujërave, kanaleve, gardheve ose mureve, shpronësimi i të cilave është i nevojshëm për shfrytëzim, ndërtim ose mirëmbajtjen e rrugëve lokale.

6.2. Shpronësimi zbatohet në përputhje me Ligjin për Shpronësimin.

Neni 7

Mirëmbajtja dhe ndërtimi i rrugëve lokale financohet nga të hyrat e Buxhetit të Komunës dhe nga kontributet e qytetarëve.

Neni 8

Asnjë personi, juridik apo fizik, nuk i miratohet kërkesa për kalimin e pronësisë në rrugë lokale ose të një pjese të këtyre rrugëve.

III. MIRËMBAJTJA

Neni 9

Drejtoria harton planin vjetor të mirëmbajtjes dimërore dhe verore për rrugët lokale, në territorin e saj.

Neni 10

10.1. Drejtoria është përgjegjës për vendosjen dhe mirëmbajtjen e shenjave të trafikut në rrugët lokale.

10.2. Drejtoria është përgjegjës për vendosjen dhe mirëmbajtjen e shenjave të trafikut në kryqëzimin e rrugëve lokale me linjat e hekurudhës.

Neni 11

Për rrugët lokale, mund të lidhen kontrata me kompanitë e besueshme të cilat janë lëndë e legjislacionit për prokurim.

IV. NDËRTIMI DHE RIKONSTRUKTIMI

Neni 12

12.1. Drejtoria harton planin vjetor të ndërtimit dhe rikonstruktimit të rrugëve lokale.

Neni 13

Drejtoria dhe pronarët e rrugëve të pakategorizuara informojnë Ministrinë përkatëse lidhur me planin për ndërtim dhe lidhjet e rrugëve me rrugët magjistrale dhe regjionale.

Neni 14

Drejtoria, në përputhje me rregullat mbi kriteret teknike për ndërtimin dhe rikonstruktimin e rrugëve publike që nxjerr Ministria, cakton rregulla sipas standardeve për ndërtimin dhe rikonstruktimin e rrugëve lokale.

V. SHFRYTËZIMI I RRUGËVE LOKALE

Neni 15

Neni 15.1 Kushdo që përdorë rrugën lokale duhet të ndërmarr të gjitha masat e nevojshme që të shmangë:

- a/ lëndimin e çdo personi i cili përdorë rrugën lokale,
- b/ dëmtimin e pronës së çdo personi, kur shfrytëzon rrugën lokale dhe
- c/ dëmtimin e rrugës.

Neni 16

16.1. Personi juridik ose personi fizik bën shkelje nëse pa arsye dhe në kundërshtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje:

- a/ bllokton një rrugë lokale ose vendos ndonjë material në atë rrugë, apo
- b/ pengon, ndërpre, shkurton ose në mënyrë tjetër dëmton rrugën lokale dhe kështu pamundëson shfrytëzimin normal të saj.

16.2. Kur gjykata shpall fajtor personin juridik ose fizik për shkelje sipas paragrafit 1 (a) dhe (b) të këtij neni ajo obligon atë që të bëjë kthimin në gjendje të mëparshme.

Neni 17

17.1. Derisa ndërtimi ose mirëmbajtja është duke vazhduar në rrugën lokale, Drejtoria mund ta mbyllë atë për trafik, për çka duhet të vendosë shenjë të qartë në atë pjesë të rrugës lokale në të cilën puna është në kryerje e sipër.

17.2. Kur rruga lokale është e mbyllur sipas nenit 17.1, asnjë person nuk mund të hyjë ose udhëtojë nëpër rrugë lokale përveç nëse:

- a/ është autorizuar nga Drejtoria,
- b/ hyrjet ose udhëtimet në rrugë lokale janë në funksion të detyrës lidhur me ndërtimin ose mirëmbajtjen e punës që është duke u kryer në atë rrugë.

17.3 Personi që shfrytëzon rrugën lokale afër trafikut në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni e bën këtë në rrezikun e tij, ndërsa Drejtoria nuk mban përgjegjësinë për ndonjë dëmtim që rezulton nga shfrytëzimi i trafikut afër rrugës lokale.

Neni 18

18.1. Në hapësirën e përcaktuar për brez mbrojtës rrugor askush nuk mund të hapë minierë, të ndërtojë liqene artificiale, fabrika dhe instalime të ngjashme që mund t'i dëmtojnë rrugët lokale në një distancë prej 30 metra nga rrugët lokale.

18.2. Në hapësirën e përcaktuar për brez mbrojtës rrugor askush nuk mund të ndërtojë objekte, rezidenca, zyra, puse, gropa septike, transmetues elektrikë dhe instalime të ngjashme që mund të dëmtojnë rrugët lokale brenda distancës prej 10 metra nga rrugët lokale.

Neni 19

Shfrytëzimi i rrugës lokale për nevoja publike të përgjithshme, si vënia e kabllave të telekomunikacionit, gypave të ujit dhe lidhjeve ajrore e nëntokësore, bëhet me pëlqimin dhe mbikëqyrjen nga Drejtoria.

VI. INSPEKTIMI

Neni 20

Zbatimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje e mbikëqyr Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë e Komunës së Hanit të Elezit.

Neni 21

Një apo më shumë komuna mund të themelojnë shërbimin e përbashkët për mbikëqyrjen e rrugëve lokale.

Neni 22

Personi juridik ose personi fizik do të dënohet me shumë prej 25 deri në 2.500 € nëse:
a/ nuk ndërmer masa të arsyeshme për të evituar dëmtimin e një personi ose pronës së një personi (neni 16);
b/ dëmton, hedh materiale ose ndryshe bën ndërhyrje në një rrugë lokale (neni 17);
c/ hyn në një rrugë lokale që është mbyllur pa marrjen paraprake të autorizimit (neni 17)

Neni 23

Personi fizik / juridik do të dënohet me shumë prej 1.000 deri në 100.000 € nëse:
a/ ndërton një objekt brenda distancës të caktuar në nenin 18;
b/ vendos kablllo të telekomunikacionit, gypa uji ose struktura të ngjashme pa pëlqimin e Drejtorisë (neni 19).

VII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 24

Rrugët lokale do të regjistrohen në libra mbi tokën, në përputhshmëri me dispozitat që rregullojnë librat mbi tokën.

Neni 25

Kjo rregullore hynë në fuqi ditën e miratimit nga kuvendi i komunës dhe do të ekzekutohet pas konfirmimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Hani i Elezit

Data: 27.11.2014

Kryesuesi i Kuvendit
Qamush Brava

